



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË

Nr. 7577/prot.

Tiranë, më 01.11.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. Nr.1197/1, datë 01.07.2008.

SHOQËRISË "IHD" SH.P.K
Rruga Drenova, Godinë private, kati i 4, Kamëz, Tiranë

Për dijëni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku "Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "IHD" sh.p.k. është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1197/1, datë 01.07.2008, për mineralin krom, në Objektivin "Pika 142, Almarine", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4427, datë 02.10.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 7577 Prot., datë 03.10.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1197/1, datë 01.07.2008, për mineralin krom, në Objektivin "Pika 142, Almarine", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma "ç" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit**

për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1197/1, datë 01.07.2008, për mineralin krom, në Objektivin "Pika 142, Almarine", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1197/1, datë 01.07.2008, për mineralin krom, në Objektivin "Pika 142, Almarine", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI**

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

KENO KLOSI

